



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 4310 Prot

Berat më, 25 .08.2021

NJOFTIM

PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE PROCEDURAL PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Në mbështetje të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 650, datë 13.09.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave, për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal”, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 49 të ligjit 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Drejtësisë, shpallim njoftimin për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal si më poshtë:

Kriteret që duhet të plotësojë një individ për të qenë përfaqësues procedural janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë diplomën e studimeve të larta Bachelor dhe Master Shkencor ose Master Profesional në shkencë sociale, juridike, psikologji, sipas legjislativës në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- c) Të ketë minimalisht 2 vjet eksperiencë pune të mëparshme në çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- ç) Të ketë trajnime në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Fëmijës;
- d) Të ketë njohuri mbi rregullat e zbatueshme për drejtësinë penale për të mitur;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

- e) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale dhunë në familje dhe vepra penale kundër personit të kryera me dashje.

Përshkrimi punës

1. Përfaqësuesit proceduralë kryejnë përfaqësimin procedural të fëmijëve në konflikt me ligjin, viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
2. Përfaqësuesit proceduralë, ushtrojnë funksionet e tyre kur kërkohet nga organi procedues duke i shërbyer në çdo rast interesit më të lartë të Fëmijës në konflikt me ligjin, të fëmijës viktimë dhe dëshmitar në procesin penal.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit
- b- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c- Fotokopje të noterizuar diplomës.
- d- Fotokopje të noterizuar të listës së notave
- e- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Çertifikata kualifikimi (në rast se ka)
- h- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
- i- Licenca e Ushtrimit të Profesionit (për psikolog)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në
Bashkinë e Beratit brenda datës 26.09.2021*

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

Arisa Toska

